REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E BUJQËSISË,ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr_____Prot .

Prrenjas, më_____/_____/2026

PROJEKT-VENDIM

NR._____, DATË _____/_____/2026

PËR

"PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË PRRENJAS, PËR AKTIVITETIN: PËRDORIMIN E ANTENËS ME VENDNDODHJE QAFË-THANË-1033 NIPT:J61824053N, NGA SHOQËRIA ONE ALBANIA, (ISH-ALBTELEKOM SH.A.)

(RINOVIM KONTRATE QIRAJE)

Të nderuar këshilltarë!.

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar, neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak", Ligjit Nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet" i ndryshuar, Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar , V.K.M-së Nr. 684, datë, 02.09.2020 "Për disa disa ndryshime e shtesa në V.K.M-së Nr.433,datë 08.06.2016,të Këshillit të Ministrave , "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit ,dhe aktualisht në administrimin të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive; Planit të mbarështimit për pyjet dhe kullotat, Ekonomia Pyjore "Prrenjas" (Afati i vlefshmërisë: Viti 2025-2034); Udhëzimit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, Udhëzimit Nr.1, datë 26.01.2017 "Për mbajtjen e Kadastrës së Fondit Pyjor Kullosor Kombëtar", në ,V.K.M-në Nr.888, datë 27.12.2022 "Rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe paksim në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimi i tyre. Kontratës së qeras Nr.4641 Prot ,Datë 12.12.2017 . "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor".

Kërkesës ,Nr.103 Prot, datë 23/01/2026 nga subjekti "ONE"Albania sh.a, (ish Albtelekom sh.a)me NIPT:J61824053N, me Adresë:Autostrada Tiranë-Durrës Km.7 Kashar Tiranë., protokolluar pranë Bashkisë Prrenjas me Nr.255 Prot., datë 27/01/2026,me objekt lënde: "Kërkesë për Rinovim Kontrate.(Qafë Thana-1033).

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas dhe Drejtorit i Drejtorisë së Bujqësisë ,Administrimit të Pyujeve dhe Kullotave të Bashkisë Prrenjas pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i kërkohet Këshillit Bashkiak Prrenjas që në mbledhjen e tijë datës _____/_____/2026, të miratojë:

Në 000 lekë

PLANI I TE ARDHURAVE	VITI 2026	VITI 2027	VITI 2028	VITI 2029
Te ardhura nga taksat dhe tarifat vendor e	138,500	140,000	142,000	143,000
- *Te ardhura Taksat e ndara*	*26,520*	*27,540*	*28,540*	*29,540*
- *Te ardhura nga Burime e Veta*	*111,980*	*112460*	*113,460*	*113,460*
Te ardhura nga transferta e pakushtezuar	304,125	314,325	325,834	336843
Transferta e pakushtezuar sektoriale	166,644	169,976	169,976	171,677
TOTALI I TE ARDHURAVE	609,269	624,301	637,811	651,520

PLANI I SHPENZIMEVE	VITI 2026	VITI 2027	VITI 2028	VITI 2029
Shpenzime korrente	519,143	523,301	527,811	531,520
Shpenzime kapitale	90,126	101,000	110,000	120,000
TOTALI I SHPENZIMEVE	609,269	624,301	637,811	651,520

3.Për zbatimin e këtij P-Vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Menaxhimit Financiar , Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore,Drejtoria e Planifikimit,Kontrollit të Territorit dhe Pronës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Institucionet në varësi të Bashkisë Prrenjas.

KRYETARI I BASHKISË
Nuri Belba

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
SEKTORI I TAKSAVE DHE TE TARIFAVE VENDORE

PROJEKT VENDIM

Nr .____, Datë___._____2026

PËR
RRJETIN E LINJAVE RRETHQYTETESE, STACIONET E QENDRIMIT, NUMRIN E ORAREVE DHE STACIONET E QENDRIMIT TAXI

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin 8308 dt 18.03.1998 "per transportet rrugore" i ndryshuar, neni 19 (rrjeti i linjave rrethqytetese miratohen çdo tre vjet), Udhezimin 5627 dt 18.11.2016 "per percaktimin e kritereve, rregullave dhe dekumentacionit per leshimin e licencave, dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne transportin rrugor te udhetareve brenda vendit" i ndryshuar, në mbledhjen Këshilli Bashkiak të datës ____.____.2026 kryetari i bashkisë:

PROPOZON:

- ***Miratimin e rrjetit te linjave rrethqytetese, stacionet e qendrimit, numrin e orareve dhe stacionet e qendrimit taksi!***

  - Miratimin e rrjetit te linjave egzistuese rrethqytetese;
    a. Rrjeti i linjave Prrenjas- Skroske- Prrenjas me kalim nga Quksi.
    b. Rrajce- Prrenjas- Rrajce me kalim Pocivalle
    c. Katjel- Kododesh- Urak- Prrenjas- Urak- Kododesh- Katjel
    d. Stravaj- Prrenjas- Stravaj me kalim nga Quksi
    e. Qukes- Prrenjas- Qukes
    f. Prrenjas fshat- Qukes- Dritaj- Karkavec- Katjel- Kotodesh- Urake- Rrajce
    g. Linja te specializuara Prrenjas- Rashtan- Prrenjas, Prrenjas- Pishkash- Skroske- Prrenjas, Gurre- Karkavec me qendrim Qukes Qender.
    h. Rrajce Sutaj- Skenderbe- Sutaj me qendrim ne Sutaj
    i. Prrenjas- Stravaj- Prrenjas
  - Miratimin e Stacioneve te qendrimit te linjave rrethqytetese dhe nderqytetese;
    a. Linjat rrethqytetese me kalim ne fshatrat e njesive adminstrative Qukes dhe Stravaj si dhe te unazes se madhe Prrenjas- Qukes- Dritaj- Katjel- Rrajce dhe Rashtan, me vendqendrim Sheshi i hyrjes te Stacioni i Trenit.
    b. Linjat rrethqytetese me kalim ne fshatrat e njësisë administrative Rrajce me vendqendrim rruga " Minatori", Bulevardi Rinia.

- Miratimin e shuarjes pjesore te tarifes se ujit te pishem me kushte pagimin e tatimit/takses/tarifes sipas nenit 6 te ligjit 86/2025 per 1930 familje ne vleren 11,624,481 leke
    - Shuhen 50% e taksave dhe tarifave vendore nese pjesa e mbetur 50% paguhet e gjitha njeheresh brenda dt 30.06.2026.
    - Shuhen 25% e taksave dhe tarifave vendore nese pjesa e mbetur 75% paguhet e gjitha njeheresh brenda dt 31.12.2026.
- Miratimin e shuarjes pjesore per kopeshte dhe çerdhe me kushte pagimin e tatimit/takses/tarifes sipas nenit 6 te ligjit 86/2025 per 99 persona ne vleren 442,175 leke
    - Shuhen 50% e taksave dhe tarifave vendore nese pjesa e mbetur 50% paguhet e gjitha njeheresh brenda dt 30.06.2026.
    - Shuhen 25% e taksave dhe tarifave vendore nese pjesa e mbetur 75% paguhet e gjitha njeheresh brenda dt 31.12.2026.
- Miratimin per shuarjen e gjobave per detyrimet tatimore qe u perkasin periudhat nga dt 01.01.2020 deri me dt 31.12.2024, per **93** subjekte me vlere **1,818,149** leke, me kushte qe tatimi/taksa/tarifa per periudhen perkatese te paguhen brenda dt 31.12.2026.

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjes vendore".

Përgjegjësi i Sektorit
Ahmet GOCI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr._____ Prot.

Prrenjas, më___. ___. 2026

P/VENDIM
Nr___datë___. ___.2026

"Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Prrenjas"

Keshilli i Bashkisë Prrenjas në mbledhjen e tij të datës ___.___.2025 me Propozim të Kryetarit të Bashkisë,mbështetur në nenin 9 pika 1.3 nenin 34 te ligjit nr 139/2015"Për Vetqeverisjen Vendore" të ndryshuar,nenit 34 të ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore"I ndryshuar të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë " , I ndryshuar,ligjit 10296 date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar , I ndryshuar, Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 ."Për procedurat standarte te pregatitjes se programit buxhetor afatmesem " , Udhëzimin e MF nr 7 datë 27.02.2026"Për përgatijen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029"me shtojcat plotësuese si dhe VKB nr 91 datë 24.12.2025 "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029.

VENDOSI

1. Miratimin e Planit të burimeve financiare të Bashkisë Prrenjas nga të ardhurat e veta , transfertat e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale ,për periudhën 2027-2029 në shumat sipas tabelave të mëposhtme:

2.Të miratojë programin e shpenzimeve buxhetore për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Prrenjas për periudhën 2027-2029 sipas tabeleve :

2.1 Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve të Bashkisë Prrenjas për periudhën buxhetore 2027-2029 është si më poshtë:

2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit, Integrimit Evropian dhe Projekteve pranë Bashkisë Prrenjas.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË

NURI BELBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
KRYETARI

Nr._____ prot.

Prrenjas, më____.____.2026

PROJEKT–VENDIM
Nr. ____ datë ____/___/2026

PËR
"NDËRMARRJEN E NISMËS TË RISHIKIMIT TË DOKUMENTIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA PRRENJAS ME PROCEDURË TË THJESHTUAR"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 23, pika 14, nenit 64, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 13, pika 1, shkronja "b", nenit 26, pika 2,të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar;Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3, datë 14.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Prrenjas", Udhëzimit nr.1, datë 06.12.2021, të Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për "Hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të Planeve të Përgjithshme me procedurë të thjeshtuar", i ndryshuar me udhëzimin nr.07, datë 08.01.2025, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Prrenjas, i mbledhur më datë ___/___/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato cështje dhe kërkesa të cilat:

   a. Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore,
   b. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territorial të ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike,ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
   c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor,
   d. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë të planifikimit apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT ,MENAXHIMIT FINANCIAR
DHE SHERBIMIT SOCIAL
ZYRA E STREHIMIT SOCIAL

Nr. _____prot. Prrenjas, më ___.___2026

PROJEKT-VENDIM

Nr._____Datë_____

"PËR MIRATIMIN E LISTËS SHTESË TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË SUBVENCIONIM QIRAJE PËR VITIN 2026 NË BASHKINË E PRRENJASIT"

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social", Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM nr.362 datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKB Prrenjas Nr.45, datë 27.03.2024 "Për miratimin e Sistemit të Pikëzimit për familjet/individët që kërkojnë të përfitojne nga programi i subvencionimit të qirasë", VKB Prrenjas nr.100, datë 26.11.2024 "Për përcaktimin e çmimit të qirasë të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionit të qirasë", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.25 datë 22.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit ", **Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit i Propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij më datë _____/_____/2026 të miratojë:**

1. Listën emërore të 7 familjeve që do të përfitojnë subvecionim qiraje për vitin 2026. (Bashkangjitur tabela me listen emërore dhe shumat e subvencionimit).
2. Miratimin në parim të masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale prej**908,000**lekë për periudhën (**Mars-Dhjetor**) viti **2026**, për tu financuar në masën **80%** nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën prej **726,400** lekë, dhe në masën **20%** nga Bashkia Prrenjas në vlerën **181,600** lekë.
3. Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për Komisionin e Strehimit 2024
4. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) dite pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Konceptoi komisjoni i vlersimit
Aurel Karriqi
Besim Hana
Elvira Kryeziu

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELIBA
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETAR I BASHKISË
Aurel KARRIQI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PRRENJAS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
SEKTORI I TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROJEKT VENDIM

Nr.____, Datë___.____2026

PËR
FSHIRJEN, SHUARJEN DHE PAGESEN E DETYRIMEVE TATIMORE VENDORE

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin 86/2025 "Per fshirjen, shuarjen dhe pagesen e detyrimeve tatimore ndaj administrates tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve te pagueshme ne dogane", në mbledhjen Këshilli Bashkiak të datës ____.____.2026 kryetari i bashkisë:

PROPOZON:

- ***Miratimin e fshirjes se detyrimeve tatimore te papaguara, shuarjen pjesore te detyrimeve tatimore, me kusht pagimin tatim/takse/tarife.***
  - Të miratojë fshirjen e detyrimeve tatimore te papaguara te percaktuara sipas ligjit 9632 dt. 30.10.2006 "per sistemin e taksave vendore" i ndryshuart, qe u perkasin periudhave tatimore deri me dt 31.12.2014. (sipas nenit 5 te ligjit 86/2025 pika 2)
    a) Shuhen taksa dhe tarifa vendore familjare per njesit administrative dhe njesin Prrenjas per 2219 familje ne vleren 9,780,524 leke (takse mbi token bujqesore, taksa mbi truallin dhe taksa mbi ndertesat e te tjera).
    b) Shuhen tarife e ujit te pishem per **228** familje ne vleren **1,235,035** leke.
    c) Shuhen detyrimet tatimore te papaguara te vendosura per subjektet pas çregjistrimit ne qkb, te subjekteve qe nuk gjenden ne Bashki e te tjera.
    23 subjekte me vleren **4,169,340** leke.
  - Miratimin e shuarjes pjesore per taksat dhe tarifat vendore familjare me kushte pagimin e tatimit/takses/tarifes sipas nenit 6 te ligjit 86/2025 per 5511 amilje ne vleren 19,960,650 leke
    - Shuhen 50% e taksave dhe tarifave vendore nese pjesa e mbetur 50% paguhet e gjitha njeheresh brenda dt 30.06.2026.
    - Shuhen 25% e taksave dhe tarifave vendore nese pjesa e mbetur 75% paguhet e gjitha njeheresh brenda dt 31.12.2026.

1. Dhënien në përdorim të sipërfaqeve prej 0.41 km të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Prrenjas, *"Për përdorim rruge dhe 0.0276 ha për përdorimin e antenës, Subjektit* **"ONE"Albania sh.a, (ish Albtelekom sh.a),** me **NIPT:J61824053N**, do të jetë sipas Kontratës së qirasë Nr.4641 Prot., Datë 12.12.2017 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor", me të drejtë rinovimi sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Vlera vjetore e dhënies me qira do të jetë sipas raportit të studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur; mbështetur në V.K.M-në Nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien e tyre në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore", shtojca nr. 1, pika 7,11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike Bashkia Prrenjas.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

DREJTORI I DREJTORISË SË BUJQËSISË,
ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
Leonard LOSHI

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI I BASHKISË
Aurel KARRIQI